

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6957  
E hënë, 31 korrik 2023  
Çmimi 0.40

PDK-ja: Zgjedhjet janë të pashmangshme dhe duhet të ndodhin sa më parë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KONJUFCA E DËRGOI NË KOMISIONIN E VENECIAS PROJEKTLIGJIN PËR KËSHILLIN PROKURORIAL



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, e ka dërguar për mendim në Komisionin e Venecias Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. I njëjti është proceduar në Kuvend ditë më parë nga qeveria. Ambasadori i BE-së në

Kosovë, Tomas Szunyog, ka mirëpritur gatishmërinë e kryeparlamentarit Konjufca që të konsultohet me Komisionin e Venecias për ndryshimet e rishikuara në Ligjin për KPK-në. Më 24 mars 2023 Gjykata Kushtetuese e

Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës pas kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë, të ushtruar nga deputetët e PDK-së dhe të LDK-së

## JAPIN DORËHEQJE MINISTRAT E BDI-së NË QEVERI



## SHTYHET VIZITA E CHOLLETIT NË BALLKAN



### AKTUALE



RAMA PARALAJMËRON VETËREFORMIM NË QEVERI DHE PARTINË SOCIALISTE F. 2

NË SENATIN E SHBA-SË APROVOHET LIGJI PËR ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT ME FSK-në F. 5

RRITET NUMRI I VIZITORËVE NË KOSOVË F. 6

### EKONOMI



KURTI THOTË SE AKTUALISHT JANË 400 MIJË TË PUNËSUAR AKTIVË FALË POLITIKAVE TË QEVERISË SË TIJ F. 7

RAPORTI I DASH-IT, AAK-ja: KONFIRMIM QË KOSOVA NUK KA ASNJË SUKSES NË ZHVILLIMIN EKONOMIK F. 7

### SPORT



UEFA CAKTON GJYQTARËT NGA KOSOVA PËR SFIDËN NË LIGËN E KONFERENCËS, LUZERN - DJURGARDEN F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Rama paralajmëron vetëreformim në qeveri dhe Partinë Socialiste

TIRANË, 30 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka paralajmëruar vetëreformim në qeveri dhe Partinë Socialiste të cilën e udhëheq ai. Ai i ka bërë këto deklarata pas një mbledhjeje dyditore joformale me ministra të kabinetit, zëvendësministra dhe drejtorë të agjencive të ndryshme. “Do të ketë një riorganizim dhe rikonceptim. Sesionin e ri ta nisim me një puls të ri, por edhe me një rritje të konsiderueshme të kapaciteteve qeverisëse, duke theksuar rolin e zëvendësministrave, duke i përfshirë në vendimmarrje edhe drejtues të agjencive të rëndësishme. Vetëreformimi është një riorganizim i procesit qeverisës në funksion të rritjes së efikasitetit dhe kapaciteteve për të arritur rezultate të shpejta”, u ka thënë Rama gazetarëve.

Ai ka thënë, po ashtu, se do të krijohet edhe një kanal i ri ndërveprimi me ekspertë

vendas dhe të huaj, me përfaqësues të botës akademike, me organizata ndërkombëtare, por edhe me individë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Duke diskutuar për takimin joformal, Rama ka përmendur se në të është diskutuar për dy reforma: në arsim dhe prokurimet publike. Sipas tij, kjo e fundit, përmes inteligjencës artificiale, do të arrijë në një tjetër nivel.

Kur është pyetur për vetëreformimin në PS, Rama ka komentuar vendimin e marrë këtë javë nga Asambleja Kombëtare për t'i shkarkuar të gjithë sekretarët e partisë, përfshirë edhe figurën e dytë të partisë, Damian Gjokurin.

Në mesin e pyetjeve për të ishte edhe ajo nëse shkarkimi i Gjokurit lidhet me përfshirjen e tij në hetimet për inceneratorët, ku është i akuzuar ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj. Sipas tij, vendimet e



Asamblesë lidhen vetëm me funksionimin më të mirë të kësaj partie.

“Po të nisemi në vendimmarrjet tona nga thashethemet apo nga përfshirjet paraprake të kujtdo goftë në një proces analize

hetimore, unë nuk di kush mbetet në këtë vend pa u bërë pis. Ndërkohë që raportin tonë me drejtësinë e kemi bërë të qartë, lëvizja e të gjithë sekretariatit nuk ka të bëjë aspak me çfarë është spekuluar me

Damianin”, ka thënë Rama. Arben Ahmetaj akuzohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për korrupsion, pastrim parash dhe mosdeklarim e fshehje të pasurisë.

## Lulzim Basha zgjedhet kryetar i Partisë Demokratike



TIRANË, 30 KORRIK – Lulzim Basha ka deklaruar se është rikthyer në krye të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD). Ai ka marrë 16 196 vota, ndërsa rivali i tij, Gjergj Hani, 1 657 . Hani nuk është deklaruar për medie.

Rezultati është konfirmuar nga Komisioni Zgjedhor në Partinë Demokratike që aktualisht është në opozitë.

Në fjalën që ka mbajtur para mbështetësve, Basha ka thënë se prej 29 korrikut nis ndryshimi i madh i Partisë Demokratike. “Pavarësisht prej vështirësive,

Partia Demokratike mbetet shpresa e shqiptarëve. Sfidat e opozitës janë të mëdha. Lumenjtë e mosbesimit rrjedhin ende, disa prej tyre të sponsorizuar nga ata që duan një Shqipëri pa mundësi ekonomike, pa liri tregu, pa konkurrencë, as në politikë, as në ekonomi, me media nën presion e me censurë, me drejtësi nën presion. Do të ndërtojmë një urë shprese e besimi për mijëra shqiptarë”, ka thënë Basha. Nëse gjithçka konfirmohet, ky mund të jetë mandati i katërt i

Lulzim Bashës në krye të PD-së. PD-ja i ka mbajtur këto zgjedhje e përçarë dhe e ndarë në tri pjesë.

Deri para këtij procesi PD-ja ishte e ndarë në dy pjesë, mes mbështetësve të Lulzim Bashës dhe atyre të Sali Berishës. Por, zhvillimi i këtij procesi e thelloi edhe më shumë përçarjen. Zgjedhjet për kreun e PD-së janë kundërshtuar nga një tjetër grup, nga sekretari i përgjithshëm Gazmend Bardhi dhe shtatë deputetë që e mbështetnin atë.

## Kurti: Zbatimi i ligjit kundër biznesmenëve që e shkelin atë nuk nënkupton sulm ndaj medieve

PRISHTINË, 30 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zbatimi i Ligjit Kundër Biznesmenëve që e shkelin atë për përfitime financiare nuk nënkupton sulm ndaj lirisë së medieve. Përmes një postimi në “Twitter”, Kurti ka thënë se liria e medieve është jetike dhe sulmi ndaj tyre përbën sulm ndaj demokracisë.

Reagimi i tij ka ardhur një ditë pasi Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e ka konfirmuar pezullimin e licencës së biznesit të televizionit lokal në Kosovë “Klan Kosova”.

“Kosova i ka 468 biznese të regjistruara, aktiviteti kryesor i të cilave është media, dhe 114 kompani të licencuara audio-vizuale. Zbatimi i rregullave të regjistrimit është detyrë ligjore, ‘jo teknikalitet’. Dhe zbatimi i rregullave të tilla kundër një shkelësi të vetëm nuk e kërcënon pluralizmin medial”.

Kurti ka thënë se në vendet demokratike institucionet e autorizuar për t'i trajtuar këto raste nuk janë pjesë e Zyrës së Kryeministrit, por që ato e kanë përkrahjen e plotë të ekzekutivit.

Më 14 qershor Ministria e

Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë (MINT) ka ngritur kallëzim penal ndaj mediumit “Klan Kosova”.

Kallëzimi penal është ngritur me “pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërrimi i pronarëve, figuron Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia”.

Pas kësaj, Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) e ka anuluar certifikatën e biznesit të “Klan Kosovës”, por më 21 qershor e ka shfuqizuar vendimin e marrë. Më pas, një ditë më vonë, ARBK-ja e ka anuluar



edhe vendimin e 21 qershorit. “Klan Kosova” ka thënë, pas vendimit të 28 korrikut, se “në asnjë rrethanë nuk do ta

pranojë një qasje të tillë autoritare” nga institucionet e shtetit dhe se çështjen do ta dërgojë në gjykatë.

# Japin dorëheqje ministrat e BDI-së në qeveri

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 KORRIK - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) Ali Ahmeti, ka thënë të dielën se ministrat dhe funksionarët e partisë që udhëheq ai kanë dhënë dorëheqje nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut.

Në "Facebook" ai ka thënë se vendimi për dorëheqje është marrë "duke u nisur nga kushtëzimi i opozitës [VMRO DPPMNE-së] se do t'i votonte ndryshimet kushtetuese nëse Bashkimi Demokratik për Integrim del nga qeveria".

Por, kreu i BDI-së ka thënë se dorëheqjet e zyrtarëve të partisë së tij do të hyjnë në fuqi pasi të votohen ndryshimet kushtetuese. "Duke qenë se Bashkimi Demokratik për Integrim dhe unë mbetemi të përkushtuar në përcaktimin se integrimi euroatlantik, me të drejta të plota të shtetit, përpos se në NATO, edhe në Bashkimin Evropian, si dhe aleanca e pashkëputur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kanë qenë, janë dhe mbeten interesi më madhor i të gjithë qytetarëve tanë, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare e fetare, ministrat dhe funksionarët qeveritarë nga radhët e

Bashkimit Demokratik për Integrim japin dorëheqje nga postet që aktualisht janë duke i ushtruar!

Dorëheqjet materializohen me automatizëm në momentin kur opozita t'i votojë ndryshimet kushtetuese", ka thënë Ahmeti në njoftimin publik drejtuar kryeministrit maqedonas Dimitar Kovaçevski.

Përmes një komunikate për medie, VMRO DPMNE-ja e ka përhëndetur njoftimin e bërë nga kryetari i BDI-së, por ka thënë se kërkon që dorëheqjet të jenë të parevokueshme dhe menjëherë të organizohen zgjedhje të parakohshme parlamentare. "Mirë është që BDI-ja pas 20 viteve të të qëndruarit në pushtet po shprehet e gatshme të kalojë në opozitë prej nga do të përgjigjet për kriminalitetin. Dorëheqjet duhet të jenë të parevokueshme dhe menjëherë të mbahen zgjedhjet. Gjithçka tjetër është humbje kohe dhe lojë në kurriz të qytetarëve dhe shtetit".

Nga Lidhja Social-Demokratike e kryeministrit Dimitar Kovaçevski kanë thënë se pas vendimit të BDI-së, opozita duhet t'i mbështesë ndryshimet kushtetuese. "Duke vënë interesin e shtetit para interesit partiak, BDI-ja tregoi përgjegjësi ndaj qëllimit kryesor strategjik,



të ardhmes evropiane të vendit dhe të të gjithë qytetarëve. Hristijan Mickoski duhet të tregojë nëse ka kapacitetin e një burri shteti dhe nëse i intereson e ardhmja evropiane e vendit të mbështesë amendamentet kushtetuese. Votimi i tyre është

votë për Evropën, për një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme".

Kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, ka thënë pas një takimi me Kovaçevskin më 7 qershor, se "VMRO-ja është e gatshme t'i mbështesë

ndryshimet kushtetuese nëse do të formohej një qeveri e re, pa BDI-në, si dhe nëse ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi vetëm pasi të kenë përfunduar bisedimet e anëtarësimit me Bashkimin Evropian".

Por, një kërkesë e tillë e VMRO-së është refuzuar edhe nga Bashkimi Evropian, pasi ndryshimet kushtetuese duhet të hyjnë në fuqi para se të nisnin bisedimet me BE-në për kapitujt e anëtarësimit.

Ndryshimet në kushtetutë duhet të bëhen për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, si popull shtetformues dhe bazohen në atë që njihet si "propozim francez" për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të Maqedonisë së Veriut me Bullgarinë. Në rast se kjo nuk ndodh, atëherë Sofja mban të drejtën e përdorimit të vetos, apo bllokimit të bisedimeve, ashtu siç bëri edhe në vitin 2020. Opozita maqedonase është kundër ndryshimeve pasi, sipas saj, "pala bullgare nuk do të ndalet me kushtëzimet e saj edhe sikur të miratohen këto ndryshime".

Debatit parlamentar për ndryshimin e kushtetutës ka nisur më 25 korrik, ndërsa seanca plenare është caktuar të mbahet më 18 gusht.

## Shtyhet vizita e Cholletit në Ballkan

PRISHTINË, 30 KORRIK - Këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet, e ka shtyrë vizitën me një delegacion amerikan në Ballkan, kanë thënë nga Presidencia e Kosovës.

Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", këshilltari për media i Presidencës, Bekim Kupina, ka thënë se vizita e paraparë për 30 korrik me liderë shtetërorë të Kosovës është shtyrë për shkaqe objektive. "Nuk ka anulim të vizitës, por jemi informuar se ka shtyrje të datës për gjithë turin ballkanik (pra Kosovë, Bosnjë- Hercegovinë dhe Serbi) për shkaqe objektive të njërit nga anëtarët e delegacionit", ka thënë Kupina. Chollet e ka vizituar Kosovën dhe disa vende të Ballkanit në janar të këtij viti. Ai pati thënë atëherë se Shtetet e Bashkuara do të jenë në pritje të një propozimi nga Qeveria e Kosovës për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me



Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Ndërkohë, tensionet në Kosovë janë rritur, pas hyrjes së kryetarëve të rinj shqiptarë

në ndërtesat komunave në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq, dhe Zubin Potok - të banuara me shumicë serbe. Komuniteti serb dhe Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, i kanë bojkotuar zgjedhjet e prillit, por as nuk i pranojnë

kryetarët e rinj.

Tensionet kanë kulmuar edhe me dhunë mes protestuesve dhe pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i ulin tensionet dhe të ulen në tavolinën e negociatave.

Më 10 korrik Kosova ka arritur marrëveshje me BE-në për ulje të tensioneve dhe në të është përfshirë edhe mbajtja e zgjedhjeve të reja në veri. Mirëpo, së fundi, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se zgjedhje nuk mund të ketë pa shtensionim të plotë të situatës në veri. "Në do të sigurohemi që kjo përvojë e re që do ta kemi me ndërprerjen e mandatit të këtyre kryetarëve në veri të ketë mbështetjen dhe garancitë ligjore dhe procedurale. Pra, duhet të sigurohemi që procesi i tillë të jetë aq i sigurt saqë të jetë i pasfidueshëm në kuptimin legal dhe juridik", ka thënë Kurti në një konferencë për medie.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune.

Ky peticion, sipas Krasniqit, më pas do të dërgohej në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), që do ta verifikonte atë dhe më pas do të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari.



## Konjufca e dërgoi në Komisionin e Venecias Projektligjin për Këshillin Prokurorial

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, e ka dërguar për mendim në Komisionin e Venecias Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. I njëjti është proceduar në Kuvend ditë më parë nga ana e qeverisë. Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka mirëpritur gatishmërinë e kryeparlamentarit Konjufca që të konsultohet me Komisionin e Venecias për ndryshimet e rishikuara në Ligjin për KPK-në. Më 24 mars 2023 Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës pas kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë, të ushtruar nga deputetët e PDK-së dhe të LDK-së

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 30 KORRIK** - Në përputhje me përgjegjësitë e tij kushtetuese, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka dërguar për mendim në Komisionin e Venecias Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. I njëjti është proceduar në Kuvend ditë më parë nga ana e

Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Duke qenë se drafti ka pësuar ndryshime që nga vlerësimi i Komisionit të Venecias, kryetari Konjufca ka kërkuar opinion për projektligjin në tërësi, duke e konsideruar vendimtar në arritjen e objektivit për reformim të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe adresimit të shqetësimeve dhe çështjeve të ngritura më parë. Si shtet anëtar i Komisionit të Venecias, Kosova mbetet e

përkushtuar ndaj respektimit të parimeve themelore të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Bashkimi Evropian ka mirëpritur vendimin e Konjufcës për të dërguar për mendim në Komisionin e Venecias, Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, thotë se pajtueshmëria me standardet evropiane është e drejtë

kryesore në zbatimin e reformave. “E mirëpres gatishmërinë e kryeparlamentarit Glauk Konjufca që të konsultohet me Komisionin e Venecias për ndryshimet e rishikuara në Ligjin për KPK. Pajtueshmëria me standardet evropiane është e drejtë kryesore në zbatimin e reformave”, ka shkruar ambasadori në rrjetin social “Twitter”.

Szunyog thotë se rekomandimet e Komisionit të Venecias duhet të zbatohen plotësisht në finalizimin e kësaj nisme të rëndësishme ligjore. Më 12 korrik 2023 qeveria ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Më 24 mars 2023 Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës pas kërkesës për

vlerësim të kushtetutshmërisë, të ushtruar nga deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës vitin e shkuar.

Kushtetuesja ka konstatuar se disa nene të këtij ligji nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Sipas vendimit të gjykatës, ligji bie ndesh me nenet e Kushtetutës për Formën e Qeverisjes dhe Ndarjen e Pushtetit, Kompetencat e Kuvendit, Rolin e Avokatit të Popullit, Barazinë para Ligjit, e Këshillit Prokurorial dhe e nenit për të Drejtën për Mjete Juridike.

Ligji për KPK-në u miratua në lexim të parë në prill të vitit të kaluar, ndërkaq në lexim të dytë në qershor të vitit të kaluar.

Dy partitë opozitare, Partia Demokratike dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, në korrik të 2022-s kanë dërguar për vlerësim të kushtetutshmërisë Ligjin për Këshillin Prokurorial.

# PDK-ja: Zgjedhjet janë të pashmangshme dhe duhet të ndodhin sa më parë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 KORRIK - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Eliza Hoxha, ka thënë në një konferencë për media të dielën se afëra e re e përgjimeve që dëshmon vjedhjen e qeverisë në rezervat shtetërore është hajni e paprecedent që e ka instaluar pikërisht qeveria e Albin Kurtit. "Keqpërdorimi me rezervat shtetërore është një nga skandalet korruptive që cenojnë jo vetëm rezervat, por edhe integritetin e përgjithshëm të institucioneve publike", tha deputetja Hoxha. Për këto abuzime e afëra korruptive në Ministri të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ajo u bëri ftesë organeve të drejtësisë që të marrin masa të menjëhershme, së pari për ta ndalë abuzimin e mëtejme që mund të jetë duke ndodhur edhe tani dhe për të vendosur para përgjegjësisë të gjithë personat e përfshirë në këtë skandal korruptiv, në qendër të të cilit qëndron ministrja

Rozeta Hajdari.

Deputetja Eliza Hoxha rikujtoi se Partia Demokratike e Kosovës tash e 6 muaj me radhë e ka ngritur shqetësimin e saj në raport me rezervat shtetërore dhe dyshimet e bazuara për keqpërdorime, si në rezervat e grurit dhe sot kur po flasim edhe për rezervat e vajit. "Rozeta Hajdari është një ministre e paaftë, e cila për dy vjet e gjysmë jo vetëm që nuk ka pasur kurrfarë rezultati, por ka qenë protagoniste e skandaleve të njëpasnjëshme. Po ju përkujtoj që Rozeta Hajdari është ministre e dënuar dhe me aktakuzë për dy çështje të ndryshme. Dhe si duket kjo nuk i mjafton dhe tashmë e shohim teksa zhytet edhe më thellë në afëra korruptive", tha Hoxha. Ajo tha se përgjimet e publikuara nga mediet dëshmojnë për negociatat e qeverisë së Albin Kurtit me palë të treta, për kompani fiktive e me llogari bankare fiktive. Dhe, mbi të gjitha, për pagesën e vajit, i cili nuk ka arritur kurrë në Kosovë. Deputetja Hoxha tha se




ministrja Rozeta Hajdari si instrument i kryeministrit Albin Kurti veptoi njësoj edhe duke ia revokuar licencën Klan Kosovës, që është një prej

medimeve më të mëdha në vend, i ngritur me mundin e qindra gazetarëve dhe punëtorëve të gjerë, të cilët, për vite me radhë, kanë dhanë një

kontribut të jashtëzakonshëm në informimin e qytetarëve tanë. "Ky veprim i paprecedent përbën një akt autoritar që ndodh në një shoqëri demokratike, dhe shpërfaq zellin e madh që ka Albin Kurti dhe qeveria e tij kundër medieve dhe fjalës së lirë. Me këtë veprim kryeministri Albin ia ka vënë një njollë të errët Republikës së Kosovës dhe rendit tonë demokratik, të cilin e kemi aspiruar dhe e duam në mesin tonë", tha Hoxha. Mbyllja arbitrare e një mediumi që nxit reagime të shumta vendore e ndërkombëtare, sipas deputetes Hoxha, jo vetëm që nuk mund të arsyetohet, por përbën një kërcënim të hapur për sistemin e vlerave demokratike dhe është i papranueshëm. "Prandaj, për Partinë Demokratike zgjedhjet janë të pashmangshme dhe duhet të ndodhin sa më parë në mënyrë që Kosova të rikthehet në profilin e saj si një shtet i ri e plot shpresë dhe me orientim të qartë e zhvillim shoqëror dhe ekonomik e demokratik", tha deputetja Eliza Hoxha.

# Dinoshia: Serbia nuk ka ndryshuar, Kosova të ketë unitet politik e koordinim me Amerikën

PRISHTINË, 30 KORRIK - Pas tensioneve të fundit në veri të vendit, ish-ambasadori i Malit të Zi në Kosovë, Ferhat Dinoshia, i bën thirrje politikës së Kosovës për unitet lidhur me çështjen e dialogut si dhe koordinim më të ngushtë me aleatët. Sipas tij, kjo do të jetë rruga më e mirë për shmangien e incidenteve dhe konflikteve eventuale në Kosovë, ose në Ballkanin Perëndimor. Në të kundërtën, thotë se çdo zvarritje e proceseve mund të mos jetë në favor të Kosovës. Ish-ambasadori Dinoshia, njëherësh kryetar i Unionit Nacional Shqiptar, në një intervistë për "Kosovapress" thotë se në veçanti kontakti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë i përhershëm. Ai flet për marrëveshjen e Ohrit si dhe shfrytëzimin e momentumit për shqiptarët pas luftës pushtuese të Rusisë në Ukrainë. Dinoshia flet edhe për



ndikimin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë bazuar në përvojën e Malit të Zi, ku tërheq vëmendjen se tendencat përtej asaj që është dakorduar deri më tani duhet të shpëriten menjëherë. Marrë parasysh propagandën e Serbisë karshi Kosovës, ai thotë se është momenti i fundit kur gjërat duhet të nisin të marrin zgjidhje në mënyrë që imazhi i vendit tonë të mos dëmtohet në botë. "Situata në

Kosovë vazhdon të jetë e paqartë dhe me tensione. Mendoj se do të ishte më mirë sikur gjërat të fillonin të merrnin zgjidhje në dobi të asaj që është interes i Kosovës dhe i rajonit në tërësi, sidomos i shqiptarëve në rajon. Pra, do të kisha dashur që të shihja që kontaktet e qeverisë aktuale të Kosovës me faktorin ndërkombëtar janë ato që prodhojnë rezultate të mira në proceset demokratike në

Kosovë. Mbase nuk jam unë ai që mund t'i jap notë në punën e qeverisë. Vetëm vërej se proceset po ngadalësohen dhe se kjo mund të mos jetë në interes të Kosovës. Pra, kontakti me ndërkombëtarët, kontakti me amerikanët, duhet të jetë permanent, duhet të jetë i përhershëm dhe duhet të jetë i sqartë, dhe maksimalisht transparent. Qytetarët e Kosovës meritojnë të dinë se çfarë po ngjan dhe meritojnë t'u thuhet qartë, se ku është pozicioni i qeverisë aktuale bashkë edhe me opozitën se disa gjëra nuk do të shkojnë drejt zgjidhjes pa punë të përbashkët edhe me opozitën e Kosovës", thotë ai. Sa i përket marrëveshjes së Ohrit, Dinoshia thotë se e njëjta mund të shkojë përtej asaj të vitit 2013 dhe, siç kanë thënë edhe disa analistë, të mos jetë e dobishme. Ai apelon për unitet politik në Kosovë në mënyrë që vendi të ecë përpara. "Kjo transparencë

duhet të jetë e pranishme edhe kur është fjala për qasjen ndaj marrëveshjeve të cilat janë arritur më parë me faktorin ndërkombëtar lidhur me marrëveshjen finale me Serbinë dhe gatishmërinë e Kosovës, në këtë rast për të qenë ose jo në binarët e realizimit të marrëveshjeve të mëparshme. Sa vërej nga këtu, më duket se situata në kohë të fundit në veriun e Kosovës ka bërë koklavitje të mëtejme, nuk ka sqaruar gjëra, as marrëveshjen e Ohrit nuk e shoh si diçka që ka sqaruar skenën politike të brendshme në Kosovë, dhe mendoj se kjo duhet të ishte e nevojshme. Mund të mos kem unë informacion të mjaftueshëm për ta vlerësuar. Por, e di se analistë të caktuar e shohin si marrëveshje, e cila mund të mos jetë e dobishme, madje mund të shkojë përtej asaj që ka paraparë për palën serbe marrëveshja e vitit 2013", thekson ai.

## Në Senatin e ShBA-së aprovohet Ligji për Zgjerimin e Bashkëpunimit me FSK-në

PRISHTINË, 30 KORRIK - Senati i ShBA-së ka miratuar ligjin me të cilin i mundësohet zgjerimi i autoritetit ekzistues Departamentit të Mbrojtjes

për ofrimin e mbështetjes për Kosovën përmes shtimit të ushtrimeve të përbashkëta si dhe trajnimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës si pjesë e

stërvitjeve shumëpalëshe. Me këtë ligj është kontribuar në thellimin e bashkëpunimit në fushën ushtarake me ushtrinë amerikane.

Një rol të rëndësishëm për miratimin e këtij ligji ka dhënë senatorja Shaheen me angazhimin e saj në sigurimin e kësaj dispozite.



## Rritet numri i vizitorëve në Kosovë

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes një njoftimi publik ka thënë se është rritur numri i vizitorëve në Republikën e Kosovës. Në njoftim thuhet se “numri i përgjithshëm i vizitorëve në Republikën e Kosovës gjatë muajit qershor të këtij viti ka pasur rritje prej 29 % krahasuar me qershorin e vitit të kaluar”. “Vlen të theksohet se nga numri i

përgjithshëm i vizitorëve 60.98 % ishin të jashtëm, kurse 39.02 % ishin vendorë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, statistikat e hotelierisë për muajin qershor 2023 rezultojnë me 13.3 % rritje të vizitorëve të jashtëm krahasuar me qershorin e vitit 2022”, bëhet me dije në njoftim. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë thotë se në total 29 317

vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga: Shqipëria, Gjermania, Turqia, Zvicra etj. “Vizitat janë evidentuar nga qëndrimet në hotelet e Republikës së Kosovës, kurse vizitat ditore nuk hyjnë në këtë evidencë e që, nëse llogariten, përqindja do të ishte shumë më e lartë. Kosova, gjithnjë e më atraktive për turistët”, bëhet me dije në njoftimin për medie.



# Grafitet që i japin ngjyrë Prishtinës

PRISHTINË, 30 KORRIK - Për tri ditë rresht 120 artistë, vendorë e të huaj, secili më kreativ se tjetri, e kanë mbushur me grafitë Rrugën B në Prishtinë. Kjo lagje, relativisht e re e kryeqytetit, është ndër zonat me më së shumti beton. Por, e ka ruajtur edhe një copë rrugë, në të cilën që shtatë vjet me radhë u mundëson artistëve ta promovojnë artin e tyre në kuadër të festivalit Meeting of Styles Kosovo.

Tema e këtij edicioni është “Masa kritike”.

Për Mattia Martinin, 33-vjeçar nga Italia, kjo është hera e parë që merr pjesë në festival. “Më pëlqejnë njerëzit, vullnetarët, organizatorët dhe mirëpritja është shumë e mirë dhe

Prishtina është super e bukur. Më pëlqen shumë niveli i artistëve. Mendoj se të gjithë janë vërtet të talentuar dhe është shumë frymëzues”, ka thënë Martin, që njihet në komunitetin e tij me nofken Chus.

Për veprën e krijuar në këtë edicion ai është inspiruar nga filmat e animuar japonezë të studios Ghibli, të cilët bazohen në kombinim të realitetit dhe fantazisë. “Kam pikturuar një balenë, është e bërë sikur të ishte një pemë. Pra, ka gjethe dhe degë që rriten si një pemë. Pra, balena po fluturon si në një univers fantastik”, ka thënë Chus për REL.

Për artisten zvicerane Line Guillod festivali përbën mundësi të mirë për t'i



shpërfaqur gratë dhe vendin e tyre në shoqëri. “Është portret i një gruaje. Emri i festivalit është ‘Masa kritike’. Mendoj se një grua duhet të ketë pushtet në shoqëri. Për mua është shumë e rëndësishme të bëj portrete grash, sepse ne duhet ta zëmë vendin tonë në rrugë, duhet të zëmë vend në shoqëri, në politikë”, ka thënë ajo.

Për dallim prej Chus, kjo nuk është hera e parë që Line është në Kosovë. “Është hera e tretë (në festival) dhe kam qenë më parë në Kosovë vetëm për pushime. Më pëlqen shumë vendi dhe mendoj se njerëzit janë shumë të këndshëm, shumë të ngrohtë. Po, më pëlqen shumë Ballkani, po ashtu edhe Bosnja”, ka thënë 42-vjeçarja.

Edicioni i këtij viti, i shtati me radhë, ka nisur më 28 korrik dhe ka përfunduar më 30

korrik. Zanafilla e këtyre organizimeve daton prej viteve '90, kur një organizatë joqeveritare me të njëjtin emër, Meeting of Styles, është krijuar në Gjermani për t'i mbështetur artistët, të cilën mund të bëjnë grafitë ligjrisht nëpër mijëra metra katrorë të zonave të braktisura.

Giovanni Laporta nga Italia, i njohur si Zarkoner, është kthyer këtë vit për herë të tretë në Prishtinë. “Unë jam 23 vjeç dhe kam rreth 10 vjet që pikturoj grafitë. Kjo është hera ime e tretë në Kosovë. Çdo vit organizimi vetëm se përmirësohet. Në përgjithësi më pëlqen shumë ky vend, vendasit janë shumë të mirë. Kombinoj shumë elementë nga arti i bukur, modelimi 3D dhe shkronjat. Unë jam në thelb një përshkrim i veprës sime të artit”, ka thënë 23-vjeçari.

## Në pikën kufitare Dheu i Bardhë vazhdon të ketë kolona, bashkatdhetarët po presin mbi tri orë

Prishtinë, 30 korrik - Vendkalimi kufitar Dheu i Bardhë po vazhdon të jetë më i ngarkuari sa iu përket kolonave. Të dhënat e fundit të publikuara të dielën nga

Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar bëjnë me dije se kolonat në hyrje te Dheu i Bardhë janë deri në 120 metra, pritja e qytetarëve në këtë vendkalim kufitar po

arrin deri në tri orë e gjysmë. Vendkalimet e tjera janë më të lira për qarkullim, dalja dhe hyrja në Kosovë mund të bëhet nga tre deri në 20 minuta.



## Kurti thotë se aktualisht janë 400 mijë të punësuar aktivë falë politikave të qeverisë së tij

PRISHTINË, 30 KORRIK - Kosova ndër vite ka pasur shkallë të lartë të papunësisë. Në të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të cilat mbulojnë tremujorin e parë të vitit 2022, papunësia llogaritet të jetë 16.6 për qind. Megjithatë, kryeministri Albin Kurti thotë se ekonomia e Kosovës për herë të parë ka mbi 400 000 pozicione të regjistruara të fuqisë punëtore aktive.

Në një shkrim në llogarinë e tij në rrjetin social "Twitter", ai ka thënë se ky është tregues i fortë i "suksesit të politikave tona të punës dhe ekonomike". "Për herë të parë ekonomia jonë ka mbi 400 000 pozicione të regjistruara të fuqisë punëtore aktive. Ky është një tregues i fortë i suksesit të politikave tona të punës dhe ekonomike që kanë ndihmuar gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, sipërmarrësit dhe të tjerët të jenë pjesëmarrëse të suksesshme në fuqinë punëtore", ka shkruar Kurti.

Të dhënat për gjithë vitin 2021 tregojnë se shkalla e papunësisë ka qenë mbi 20 për qind. Sipas ASK-së, nga mbi 1.2 milion qytetarë në moshë pune, mbi 380 mijë janë të punësuar, mbi 77 mijë janë të papunë dhe mbi 750 mijë janë ekonomikisht joaktivë - që do të thotë se nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Shumë të rinj në Kosovë përgjatë viteve janë aftësuar në profesione të ndryshme në Agjencinë e Punësimit - institucioni kryesor në fushën e punësimit dhe



aftësimin profesional. Përmes shtatë qendrave të saj nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, kjo agjenci ofron trajnime për mbi 30 profile të profesioneve të ndryshme, përfshirë: moler, murator, suvatues, kuzhinier, furrtar, pastaj për saldim, administrim biznesi, floktari e të tjera.

Por, shumë të rinj që aftësohen në këto qendra largohen nga Kosova për t'u punësuar jashtë vendit.

Udhëheqës të këtyre qendrave kanë deklaruar se shumë prej tyre synojnë tregun e Bashkimit Evropian. Sipas ASK-së, në vitin 2021 nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë. Në vitin 2020 kur ka shpërthyer pandemia e koronavirusit nga Kosova kanë emigruar mbi 8 000 veta; më 2019 mbi 34 000; më 2018 mbi 28 000.

### Bajrami i reagon Kurtit: Publikoni shifrat e qytetarëve të ikur nga Kosova prej që jeni në pushtet

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, i ka reaguar Kurtit ndaj deklaratës se Kosova ka shënuar mbi 400 mijë vende të punës të regjistruar si rezultat i politikave të tij. Por kjo e deklaratë e Kurtit, sipas Bajramit, është e propagandë dhe manipulim me shifra. "Manipulorë të shifrave, a të flasim me trendë, sepse e vërteta është ndryshe nga propaganda: Me politikën e juaja të punësimit, kompanitë private po i humbin jo vetëm punëtorët por edhe

konsumatorët. Publikoni shifrat, sa qytetarë kanë ikur nga Kosova prej që ju keni marrë të gjitha nivelet e pushtetit", ka thënë Bajrami.

Ish-ministria Bajrami ka thënë se, sipas ATK-së, trendët e punësimit janë këto. "Dhjetor 2019: 331 811 të punësuar. Dhjetor 2020: 356 909 të punësuar, d.m.th. 25 098 më shumë se në vitin paraprak. Dhjetor 2021: 378 385 të punësuar, d.m.th. 21 476 më shumë se vitin paraprak, ndërsa

në korrik 2023 qenkan 404 965 të punësuar, d.m.th. 26 580 më shumë se një vit e gjysmë më parë. Me çka po lavdëroheni? Derisa nga 21-26 mijë vende të reja të punës më herët janë krijuar për një vit, tani për një vit e gjysmë paskemi 26 580 vende të reja të punës më shumë. Trendi është rënës", ka theksuar ajo.

Deputetja Bajrami ka thënë se Kosova vazhdon të jetë nën sanksione si rezultat i politikave të qeverisë Kurti.

## Raporti i DASH-it, AAK-ja: Konfirmim që Kosova nuk ka asnjë sukses në zhvillimin ekonomik



Prishtinë, 30 korrik - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka komentuar Raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për "klimën e investimeve në Kosovë" për vitin 2023.

Tahiri përmes një postimi në "Facebook" ka thënë se ballafaqimi me shumë kriza të njëpasnjëshme të qeverisë Kurti, raporti i DASH-it nuk u trajtua me seriozitet nga ana jonë. "Raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për 'klimën e investimeve në Kosovë' për vitin 2023, konfirmon atë që ne vazhdimisht e kemi evidentuar, që kjo qeveri i ka humbur dy vite, pa asnjë sukses në fushën e zhvillimit ekonomik. Më specifikisht, theksohet se investimet e huaja direkte mbetën të kufizuara dhe se remitencat janë shtytësi kryesorë i zhvillimit ekonomik. Ky saktësim i

raportit të DASH-it, kaloi pa u trajtuar me seriozitet, sepse po ballafaqohemi me krizë pas krize të kësaj qeverie!", ka theksuar Tahiri.

Ai ka thënë se problemet strukturore si ndërhyrjet politike në gjyqësi, sektori i paqëndrueshëm ekonomik, apo ekonomia informale janë pikat kryesore që paralajmërohen në hyrje të raportit. "Është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që në këtë raport të gjendet ndonjë referencë për ndonjë arritje domethënëse në ndonjë sektor të caktuar. Pa vizion, pa njohuri, pa kapacitete, pa potencial për diversifikim të burimeve dhe investimeve, kjo qeveri menaxhon në ekonomi, me logjikën e shpërndarjes së buxhetit dhe fryrjes së procedurave dhe burokracisë. Si në secilën fushë, kjo qeveri i ktheu premtimet në mashtrim qeverisës kolosal", ka deklaruar Tahiri.

# Sekretet e fshehura të Versajës



Pallati i Versajës është një nga ndërtesat më madhështore dhe më të rëndësishme historike në botë. Ky pallat mbresëlënës ishte dikur rezidenca e mbretërve dhe mbretëreshave franceze dhe ka një histori të pasur dhe magjepsëse, e cila i ka mahitur vizitorët për shekuj me radhë. Por e dini se ai bart ende shumë sekrete dhe thesare të fshehura, të cilat nuk janë të hapura për publikun? Ja cilat janë disa prej tyre:

## 1. Një kalim sekret

Injohur si “Kalimi i Fshehtë” ose “Shkallët e Fshehta”, kalimi ndodhet në apartamentet e mëdha të Pallatit dhe është përdorur nga mbreti dhe zonjat e tij për t’u arratisur nga pallati pa u vënë re. Ai u ndërtua gjatë mbretërimit të Luigjit XIV dhe u përdor për të shmangur oborrtarët dhe rojet e pallatit. Ai ishte shumë i vlefshëm gjatë Revolucionit Francez dhe u përdor për të larguar njerëzit në fshehtësi nga pallati. Vendkalimi është i fshehur pas një dere të maskuar si një raft librash. Kjo derë të çon në një shkallë të ngushtë, e cila të udhëheq në një dalje të fshehtë në kopshtet e pallatit. Kalimi është shumë i ngushtë dhe mund të përdoret vetëm nga një grup i vogël e njerëzve në të njëjtën kohë. Sot qasja tek ky vendkalim është e kufizuar, dhe vizitorët duhet të bëjnë një rezervim paraprak.

## 2. Dhoma Sekrete

Mbreti Luigji XV ndërtoi enkas një dhomë sekrete në Pallatin e Versajës, të cilën e përdorte për të organizuar takime dhe diskutime “të fshehta”. E njohur si Secret du Roi, dhoma ndodhet në krahun verior të

pallatit, pranë Apartamenteve Private të Mbretit. Mbreti e përdorte si zyrën e tij private dhe si një dhomë takimesh me këshilltarët e tij më të afërt.

Dizajni i dhomës është i veçantë. Për shkak të natyrës së saj sekrete, dhoma ishte projektuar për të qenë plotësisht e papërshkueshme nga zëri. Tek ajo arrihet përmes një dere të maskuar si një raft librash. Dera e saj mund të hapej vetëm nga një mekanizëm sekret i njohur vetëm për mbretin dhe një grup të vogël njerëzish të besuar. Secret du Roi u përdor për një sërë takimesh konfidenciale, si për shembull diskutimet e çështjeve shtetërore dhe negociatat diplomatike sekrete.

## 3. Maria Antoneta dhe “Petit Trianon”

Në vitin 1774, mbretëreshës Maria Antoneta iu dhurua “Petit Trianon”, një pallat më i vogël i vendosur brenda kompleksit më të madh të pallateve nga Luigji XVI si një vendstrehim privat. Antonetës i pëlqente privatësia e saj, ndaj “Petit Trianon” ishte projektuar për të qenë hapësira e saj private, ku mbretëresha mund të shpëtonte nga vështirësitë e jetës së oborrit dhe të shijonte pak pushim me miqtë e saj të ngushtë (dhe nëse duhen besuar thashethemet, edhe të dashurit e saj). Thuhet se edhe “Petit Trianon” kishte vendkalimin e tij sekret, që supozohet se e bashkon atë me pallatin kryesor dhe i jepte mundësinë Antonetës të shkonte dhe vinte pa u vënë re. Vendndodhja e saktë e vendkalimit është sot një mister dhe nuk dihet nëse ekziston ende.

## 4. Luigji XIV dhe Kabineti i Kurioziteteve

Një nga gjërat më të mira të të qenit mbret, është padyshim të pasurit para por edhe fuqi për të kënaqur vërtet pasionet dhe interesat e tua. Në rastin e Luigjit XIV, kjo çoi në krijimin e Kabinetit të Kurioziteteve. Ai përmbante një koleksion të madh ekzemplarësh natyrorë, instrumentesh shkencorë, vepra arti dhe gjëra të tjera të çuditshme dhe të rralla, të cilat mbreti i kishte mbledhur gjatë viteve.

Fillimisht u vendos në një dhomë të vogël, ngjitur me apartamentet private të mbretit dhe mbikëqyrej nga Zhan-Baptist Kolber, një mbrojtës i arteve dhe shkencave dhe Ministri i Financave. Edhe pse nuk ishte një sekret shtetëror, vetëm disa njerëz të përzgjedhur, lejoheshin që të hynin brenda për ta parë. Disa nga objektet përfshinin një bri rinoceronti, një guaskë të madhe deti, një krokodil të balsamosur dhe një pjesë të Kryqit të Vërtetë.

Kabineti u rrit në përmasa dhe kompleksitet, duke u bërë një nga koleksionet më të mëdha dhe më gjithëpërfshirëse të ekzemplarëve të historisë natyrore në botë. Fatkeqësisht, ai u shkatërrua në vitin 1753 dhe u zëvendësua nga Salloni i Lojërave shumë më pak spektakolar.

## 5. Maria Antoneta kishte teatrin e saj privat

Mbretëresha e përdori atë për të vënë në skenë drama, komedi dhe shfaqje muzikore për miqtë dhe familjen e saj më

të ngushtë. Teatri, i njohur si Théâtre de la Reine, ose Teatri i Mbretëreshës, ndodhej brenda “Petit Trianon”. Ai është projektuar në stilin neoklasik me një skenë të vogël dhe ndenjese për rreth 200 persona. Ishte zbuluar me afreske të përpunuara, mbulesa të praruara dhe perde me shumë qëndisma. Zakonisht shfaqjet muzikore zgjidheshin nga vetë Antoneta dhe prireshin të ishin komedi dhe opereta të lehta. Thuhej se ajo ishte një muzikante dhe aktore e talentuar dhe shpesh merrte pjesë vetë në shfaqje.

## 6. Salla e Pasqyrave

Është një nga dhomat më ikonike në Pallatin e Versajës. Fillimisht u projektua për të nderuar fitoret ushtarake të Luigjit XIV, por përdorimi i saj ndryshoi me kalimin e kohës. Ndodhet në katin e parë të pallatit dhe shtrihet në të gjithë gjatësinë e ndërtesës, duke ofruar një panoramë mahitëse të kopshteve të pallatit.

Salla u projektua nga arkitekti Zhyl Harduin-Mansar dhe u përfundua në vitin 1684. E ka marrë këtë emër nga 357 pasqyrat që veshin të gjitha muret e dhomës. Këto pasqyra janë edhe sot mbresëlënëse. Prodhimi i tyre me cilësi të lartë ishte një sekret.

Kur u ndërtua kjo sallë, Venecia kishte monopolin e prodhimit të pasqyrave më të bukura në botë, dhe thuhej se Franca duhej të rrëmbente prodhuesit venecianë të pasqyrave për të përfunduar sallën. Sipas legjendës, qeveria veneciane ishte aq e vendosur që të ruante monopolin e saj, sa që i ndaloi krijuesit e pasqyrave të

saj të largoheshin nga qyteti. Kush e bënte këtë dënohej me vdekje. Kjo do të thotë se ndërtimi i sallës do të ishte tepër i shtrenjtë dhe po ashtu një proces shumë i fshehtë.

## 7. Ka një kishë të vogël sekrete

E vendosur në katin e parë të pallatit, tek ajo mund të hyhet vetëm përmes një dere tjetër të fshehur në Dhomën e Mbretit. Kisha e vogël u përdor nga familja mbretërore për ceremoni fetare më private dhe intime. Ajo u ndërtua në fillim të shekullit XVIII-të gjatë mbretërimit të Luigjit XV dhe ishte projektuar për të qenë një vend ku mund ta faleshin të qetë familja mbretërore dhe miqtë dhe këshilltarët e tyre më të ngushtë.


## 8. Ka një tunel sekret që e lidh me pjesën e jashtme

Ai u ndërtua në shekullin XVII-të gjatë mbretërimit të Luigjit XIV dhe u përdor për të transportuar në fshehtësi ushqime dhe njerëz midis pallatit dhe qytetit. Tuneli ishte rreth 1 km i gjatë dhe u gërmua thellë nën tokë për të shmangur zbulimin.

Ishte mjaftueshëm i gjerë për të lëvizur edhe me karroca dhe kuaj dhe ishte i veshur me mure tullash dhe tavane të harkuar. Ai u përdor kryesisht për praktikant e përditshme. Pati një rol edhe më të rëndësishëm gjatë Revolucionit Francez, gjatë të cilit u përdor për të nxjerrë jashtë anëtarët e familjes mbretërore dhe mbështetësit e tyre. / *Ancient Origins – Bota.al*



# Si do të zhduket Universi? Hipoteza e fundit



Zgjerimi i pafund, Kërcitja e Madhe, singularitet, staticitet (dhe shumë më tepër): Hipotezat se cili do të jetë fati përfundimtar i Universit janë të shumta, dhe shumë të ndryshme nga njëra-tjetra (dhe për fatin tonë të mirë e përcaktojnë fundin shumë larg në kohë tani).

Tani kësaj liste i shtohet një studim i ri, i cili bazohet mbi teorinë e avullimit të Vrimeve të Zeza të formuluar nga i ndjeri Stephen Hawking. Sipas këtij modeli, të zhvilluar nga Michael Wondrak, Walter van Suijlekom dhe Heino Falcke, astrofizikanë në Universitetin Radbaud në Holandë, Universi ynë po “avullon” ngadalë para syve tanë dhe do të zhduket kur të mbarojë ky proces

avullimi.

Le të përpiqemi ta kuptojmë çështjen në terma më të thjeshtë. Teoria e Avullimit të Vrimeve të Zeza u formulua nga Stephen Hawking në vitin 1974. Ajo parashikon se ndonëse këto objekte kanë një fushë gravitacionale aq të fuqishme, sa që nuk mund t’u shpëtojnë as lënda dhe as drita, ekzistojnë disa efekte kuantike dhe kushte të veçanta, ku Vrimeve të Zeza mund të avullojnë ngadalë, duke emetuar vazhdimisht një rrezatim termik (i ashtuquajtur i Rrezatimi Hawking).

Siç shpjegohet nga Instituti Kombëtar i Astrofizikës në SHBA, ky avullim do të çonte në ngushtimin e horizontit të

ngjarjeve të një Vrime të Zeze, një proces ende i pavërejtur, faza përfundimtare e të cilit përfaqëson nga ana tjetër, një nga misteret e mëdha të fizikës teorike.

Me pak fjalë jemi ende në fushën e hipotezave, mbi të cilat shkencëtarët kanë punuar prej shumë kohësh. Në një studim të botuar në prill të këtij viti, sërish në “Physical Review Letters”, e nënshkruar nga një grup studiuesish nga departamenti i fizikës së Universiteti Sapienza i Romës, Instituti Kombëtar i Fizikës Bërthamore në Itali dhe Instituti Niels Bohr në Danimarkë, ka treguar përmes simulimeve komplekse numerike disa “fate” të mundshme për procesin e

avullimit të Vrimeve të Zeza, përfshirë shfaqjen e të ashtuquajturave “singularitete” (pikat në të cilat dendësia e materies arrin vlera kaq të larta, sa të shkaktojë një kolaps gravitacional të hapësirë-kohës) edhe jashtë vetë Vrimeve të Zeza.

Kjo do të shkelte parimin e “censurës kozmike” të formuluar nga fizikanti Roger Penrose, sipas të cilit singularitetet janë gjithmonë brenda Vrimeve të Zeza, dhe nuk mund të jenë në komunikim me botën e jashtme. Por në një skenar alternativ, parashikohet që Vrimeve të Zeza mund të kthehen në “krimba”, pra në struktura (deri tani vetëm hipotetike) që janë në gjendje

të lidhin pika të ndryshme të hapësirë-kohës.

“Ne kemi treguar se përveç rrezatimit të mirënjohur Hawking, mund të ketë edhe një rrezatim tjetër të panjohur deri më tani”- thotë Wondrak. Pra analogjia është kjo:nga Vrimeve të Zeza mund të “avullojnë” në mënyrë spontane grimcat që u shpëtojnë atyre (Rrezatimi Hawking); grimcat mund të “avullojnë” spontanisht nga fusha elektrike dhe ta shkatërrojnë atë (Efekti Schwinger). Më pas ndoshta edhe nga hapësira-koha, grimca të tjera mund të “avullojnë” spontanisht, në kushte të caktuara gravitacionale. / Galileonet – Bota.al



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 28.07.2023 bënë shpallje publike:

**NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-09**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave  
Depoja e prodhimit - Industria Kimike  
Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë  
Numri i ofertave të pranuar: 1 (një)

**ME KONTRATË SHPËRBLEHET**

Loti 1 Çmimi 509.76 €/Muaj/Me TVSH – INNO Recycling

Kontrata është paraparë të nënshkruhet me datën 02.08.2023 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: hajdini_b@hotmail.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepccorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 datë 11.01.2021.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albert Dina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IX - SHFMU "Faik Konica" Celinë.

- Besmir Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI –IX- SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Durim Lubiceva shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

